



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

SYLLABUSI i Lëndës: Ekonometria

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Biznesit
Titulli i lëndës:	Ekonometria
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	III (semestri i V)
Numri i orëve në javë:	3+3
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	FB
Mësimdhënësi i lëndës:	
Detajet kontaktuese:	
Përshkrimi i lëndës	Në kuadër të kësaj do të studentët do të përfitojnë njohuri të rëndësishme mbi aplikimin e instrumenteve analitike dhe teknika (STATA/SPSS) që të jenë më të sofistikuar në hulumtimet e tyre ekonomike karahasuar me të tjerët. Në fillim studentët do të mësojnë mbi metodologjinë ekonometrike, korelacionin, ndërtimin e modeleve me dy variabla dhe pastaj do të vazhdojnë me llojet e modeleve ekonometrike dhe do të përfundojnë me regresionin e shumfishtë. Si pjesë e të mësuarit do të jetë edhe analiza e besueshmërisë së modeleve ekonometrike duke analizuar besueshmërinë e koeficientëve dhe besueshmërinë e modelit si tërësi.
Qëllimet e lëndës:	Qëllimi i kësaj lënde është që të mësojë studentët lidhje mbi rolin, dhe rëndësinë e ekonometrisë në kuantifikimin variablave ekonomike, metodat dhe modelet ekonometrike si dhe mënyrën e aplikimit të tyre në analizat ekonomike.
Rezultatet e pritura të nxënies:	• Studenti ka njohuri relevante nga fusha e ekonometrisë duke filluar nga metodologjia ekonometrike deri te ekonometria aplikative; • Studenti ka njohuri në llogaritjen, vlersimin, testimin edhe interpretimin e modeleve ekonometrike;

	• Studenti ka njohuri për analizën e matjeve të variablave ekonomike edhe atë në nivel mikroekonomik, makroekonomik dhe atij financiarë; • Studenti ka njohuri mbi ndërvlerësinë midis dy variablave, të studiojnë lidhjen që ekziston midis tyre duke u bazuar në modelime të thjeshta, të analizojë lidhjet korrelative midis variablave, etj. • Studenti njihet me parametrat e regresionit linear si dhe llojet e modeleve ekonometrike (log-log, lin-log, log-lin dhe eksponenciale dhe reciproke). • Studentët janë në gjendje që dituritë e fituara në lëminë e ekonometrisë nepermes programeve te ndryshme si e tillë STATA/SPSS, t'i implementojnë në procese te ndryshme kerkimore.
--	---

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)

Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjerata, Kolokvium	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	3	15	45
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në teren	1	5	5
Seminare, projekte, prezentimet,etj.	10	1	10
Koha e studimit vetanak të studentit	12	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	1	10	10
Përgaditja përfundimtare për provim	5	1	5
Totali			150

Vërejtje: 1 ECTS kredi = 25 orë angazhim, p.sh. nëse lënda i ka 6 ECTS kredi studentit duhet të ketë angazhim gjatë semestrit 150 orë.

Metodologjia e mësimdhënies:	Metoda e ligjërimit është interaktive, duke u mundësuar studentëve që të bëjnë pyetje për problemet aktuale në kuadër të ligjëratës së mbajtur. Po ashtu, studentët kanë mundësi që për problemet që kanë gjatë përgatitjes së lëndës të kontaktojnë me profesorin dhe të marrin udhëzime adekuate nga ai në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimi dhe suksesit të studentëve.
Metodat e vlerësimit:	Vijueshmëria e regullt – Vijuesit përcillen në

		vazhdimësi për pjesëmarrjen fizike në orët e ligjëratave, të ushtrimeve, në punën praktike etj. Vijimi i rregullt dhe shkalla e angazhimit është kusht për fitimin e pikëve nga kjo fushë. Përcjellja bëhet nga mësime dhënësi- bashkëpunëtori dhe mentori, i cili mundësohet përmes protokollit përkatës. <u>Quiz</u> – përfshijnë test vlersues para nisjes së njësive të re mësimore në lidhje me leksiokonin e ligjeruar në orën e kaluar. Kjo mundëson që studentët të jenë aktiv gjatë tërë semestrit si dhe do të mundësojë studentët më lehtë të përgatitin lëndën për provim intermediar dhe përfundimtarë. <u>Provimi intermediar</u> – organizohet për përmbajtjet teorike të mësimit, mbahet me shkrim. Afati caktohet në marrëveshje me vijues në fund të javës së gjashtë nga fillimi i ligjëratave. <u>Provimi përfundimtar</u> – organizohet pas përfundimit të semestrit dhe shërben për vlerësimin e përmbajtjeve teorike dhe praktike. Respektohen pikët e fituara nga komponentët e mësimeve dhe të akumuluarat, krahasohen me shkallën numerike për të përcaktuar arritjet e studentit dhe për t'i shprehur ato numerikisht në protokollin e vlerësimit. Data e provimit caktohet nga sekretaria e degëve përkatëse.
Literatura		
Literatura bazë:		• Jeffrey M. Wooldridge `Introductory Econometrics` 4-tth Edition, Michigan State University, 2009. • Prof. Dr. Myslym Osmani "Metodat e Ekonometrise", Tirane 2005.
Literatura shtesë:		• Ch. Baun" Study guide, Econometrics ` McGraw-Hill, US, 2008 • Ch. Dougherty "An introduction to Econometrics" Oxford, University press, UK, 2011 • Lembcke, C. Alexander. An Introduction to STATA. London Economics School, UK, 2010
Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjerata që do të zhvillohet	
Java e parë:	Prezantimi i syllabusit	

Java e dytë:	Hyrje në Ekonometri
Java e tretë:	Metodologjia ekonometrike
Java e katërt:	Analiza e korelacionit
Java e pestë:	Dy variabla në analizën e korelacionit
Java e gjashtë:	Metoda e katrorëve të vegjël dhe supozimet e Gausit
Java e shtatë:	Hyrje në SPSS/SATA
Java e tetë	Testi I
Java e nëntë:	Preciziteti dhe vetitë e katrorëve të vegjël
Java e dhjetë:	Testimi i hipotezës
Java e njëmbëdhjetë:	Modeli ekonometrik nëpërmjet origjinës dhe log-log modeli
Java e dymbëdhjetë:	Modeli ekonometrik lin-log dhe log-lin
Java e trembëdhjetë:	Modeli ekonometrik eksponencial dhe reciprok
Java e katërbëdhjetë:	Modeli ekonometrik me më shumë se dy variabla dhe regresioni i shumefishtë
Java e pesëmbëdhjetë:	Testi II

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:
Kërkohet nga studentët që të diskutojnë midis veti dhe me ligjëruesin/asistentin e lëndës rreth përmbajtjeve të temave konsistuese. Mirëpo, pandershmëria akademike nuk e hiqshme dhe nuk do të tolerohet. Për shkeljen e integritetit akademik nga ana e studentëve do të merren masa adekuate, në përputhshmëri me Rregulloren e Universitetit të EJT. Shkelja e integritetit akademik përfshin një ose më shumë nga gjërat në vijim: ☞ Kopjimi gjatë provimit nga një student tjetër ☞ Përdorimi i shënimeve ose librave të palejuara gjatë provimit ☞ Shkëmbimi i informatave me një student tjetër gjatë provimit ☞ Plagjiatura e punimeve të huaja ☞ Dhënia e deklaratave të rrejshme për të arsyetuar dike nga mësimi apo provimi. ☞ Çdo student duhet të ndjekë të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të orëve të

lëndës (Ligjërata dhe Ushtrime), që të mund të hyjë nëprovim.

Situatat në vazhdim në lidhje me sjelljen profesionale janë të padëshirueshme dhe është në dobi të të gjithëve që ato të evitohen, si për shembull:

1. Vonesa të tepruara,
2. Lëshim i klasës gjatë ligjëratave pa arsye,
3. Tregimi i shenjave të qarta të mosinteresimit,
4. Te folurit e pandërprerë ose forma tjera të sjelljes që pengon të tjerët,
- 5.** Mbajtja e telefonit celular të hapur gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve